99 letra për Nuranën

Berzat Sadiki

Boton:
Shoqata e shkrimtarëve PRO LITERA
Rr. 167, nr. 6, Tetovë 1200
Republika e Maqedonisë së Veriut
shoqataprolitera@gmail.com

Redaktor: Mensur Mamuti

Lektori, recensenti, përpunimi grafik:
PRO LITERA

Shtypi: Art grafik, Tetovë

Tirazhi: 1000 kopje

Berzat Sadiki

99
letra për Nuranën

Poezi me filozofi kuantike



PRO LITERA
2025, Tetovë

AKT THEMELIMI

Me këtë akt shpalljeje,
në praninë e fjalës, të dritës së saj dhe
të nderit poetik,
vërtetohet themelimi i një gjinie të re letrare
në letërsinë bashkëkohore:

KUANTOPOEZIA
(Poezia me filozofi kuantike)

E konceptuar si ndërthurje
e dritës, energjisë, valës dhe shpirtit poetik,
Kuantopoezia e kapërcen linearen
dhe e vë fjalën në dimensionin e saj energjetik,
si kuant mendimi, ndjenje dhe drite.

Me këtë vepër,
"99 letra për Nuranën",
shënohet themelimi zyrtar
i kësaj gjinie të re letrare.
Themelues: **Prof. Berzat Sadiki**

Tetovë, 2025

CERTIFIKATË THEMELIMI

Me këtë dokument të posaçëm,
vërtetohet dhe zyrtarizohet themelimi
i një gjinie të re letrare në letërsinë bashkëkohore:

KUANTOPOEZIA

(Poezia me filozofi kuantike)

e konceptuar si shkrirje e dritës, energjisë,
valëve mendore dhe shpirtit poetik,
Kuantopoezia i jep fjalës statusin e kuantit:
energjik, të padukshëm, dridhës dhe krijues.

Kjo certifikatë konfirmon se themelimi zyrtar
i kësaj rryme letrare është bërë
përmes veprës poetike:

"99 letra për Nuranën"

dhe se autori i saj është themelues i kësaj gjinie:
Prof. Berzat Sadiki

Tetovë, 2025

Dedikim

Në emër të Zotit të Gjithësisë,
që më dha frymë, fjalë dhe udhë
për të ecur drejt dashurisë që s'ka fund!

Ia përkushtoj këtë vepër babait tim të dashur,
Zeqirit, që ma mësoi forcën e urtësisë dhe
qëndrueshmërisë.
Nënës sime, Asijes, që me duart e saj të buta ma
mësoi dashurinë si dritë e shpirtit.
Dhe familjes sime të ngushtë, që është streha
e përditshme e shpirtit tim, rrënja e çdo frymë që
shndërrohet në varg.

(me dashuri dhe dritë)
Berzat Sadiki

Hyrje

“99 letra për Nuranën” nuk është vetëm një libër, por një udhëtim dritësor brenda fjalës, mendimit dhe ndjenjës së njeriut. Secila letër është një grimcë energjetike, një kuant drite që lëviz në trajektoren e vet, për ta prekur zemrën dhe mendjen e lexuesit.

Kjo vepër ndërtohet mbi dy dimensione:
atë **linear**, që rrjedh si shkrim klasik,
dhe atë **kuantik** që depërton
thellë në brendësi si valë energjie.

Nëpërmes kësaj forme të re, përpiqem ta çoj fjalën
në një nivel më të lartë ndjesie dhe kuptimi -
atë ku mendimi merr dritë dhe drita bëhet poezi.

Këto letra nuk janë të zakonshme:
ato janë frymë, janë trajektore energjie,
janë përjetime të ndritshme dashurie.

Uroj që lexuesi t'i ndjejë si udhërrëfyes të butë
që i flasin shpirtit, njësoj siç më kanë folur mua
gjatë shkrimit të tyre.

Berzat Sadiki, Tetovë, 2025

PARATHËNIE ANALITIKE

Në udhëtimin e dritës, fjala bëhet frymë

"99 letra për Nuranën" nuk është thjesht një libër dashurie, është një udhëtim ndërmjet shpirtit dhe dritës, ndërmjet kujtimit dhe përjetësisë.

Këto letra nuk janë të shkruara për t'u lexuar vetëm me sy, por për t'u ndier me frymë. Në to, autori nuk rrëfen një histori, por shfaq një proces transformimi të ndërgjegjes, ku dashuria kalon nga ndjenja njerëzore në energji universale.

Në qendër të këtij udhëtimi qëndron filozofia e kuantopoezisë, një rrymë e re poetike që e bashkon fjalën me energjinë dhe artin me ndërgjegjen.

Berzat Sadiki, si themelues i kësaj rryme, e sheh poezinë si formë të valëzimit të shpirtit në fushën e dritës. Ai e përkufizon ndjenjën jo si përjetim emocional, por si frekuencë të brendshme që rezonon me kozmosin.

Në këtë frymë, çdo letër bëhet njësi drite, një impuls që përçon dashuri nëpërmes vibrimit poetik.

Por materia poetike e këtij libri nuk mbetet vetëm në sferën shpirtërore, ajo preket dhe zbatohet në jetën reale.

Në vargjet e tij gjenden fraza dhe përjetime që e pasqyrojnë dashurinë njerëzore në formën e saj më të pastër - dashurinë lineare që e lidh njeriun me njeriun, shpirtin me shpirtin, burrin me gruan, prindin me fëmijën, mikun me mikun.

Këtu, poeti nuk flet për një dashuri të paarritshme, por për një mënyrë të të jetuarit në dashuri, për një model ndërnjerëzor që mund të ndiqet në jetën e përditshme. Në këtë kuptim, *99 letra për Nuranën* bëhet manual i butë i shpirtit, që e mëson njeriun si të dojë me zemër, por të jetojë me dritë.

Ky dimension njerëzor është thelbësor: dashuria nuk është vetëm frymë që ngrihet lart, por rrënjë që e mban njeriun tokësor e të dashur.

Në shumë letra, fjala bëhet udhëzim për marrëdhëniet reale: për faljen, durimin, kuptimin, përkushtimin dhe besnikërinë.

Autori flet me një gjuhë që, ndonëse metafizike, ajo ka themel njerëzor, duke e bërë librin një urë mes jetës së brendshme dhe jetës së përditshme.

"99 letra për Nuranën" është një manifest i dashurisë kuantike - një dashuri që nuk ka trup, por energji; nuk ka zë, por jehonë; nuk ka fund, por kthim në burim. Në këtë libër, dashuria nuk kërkon të zotërojë, por të ndriçojë.

Autori e çliron ndjenjën nga materia dhe e shndërron në forcë që e lidh shpirtin me gjithësinë.

Kështu, çdo letër nuk është letër e zakonshme, por një fazë e ngritjes shpirtërore, ku nëpërmes kujtimit, dhimbjes, dashurisë, qetësisë dhe dritës, poeti arrin në gjendjen e paqes së plotë.

Në letrat e para, dashuria shfaqet si kujtim që digjet brenda shpirtit; në të mesmet, ajo bëhet frymë që lëviz nëpër ajër; ndërsa në letrat e fundit - si dritë që s'ka më formë, por përfshin gjithçka.

Në këtë mënyrë, *99 letra për Nuranën* ndërtohet si cikël energjik, që e ndjek të njëjtin parim si vala kuantike: ajo fillon, lëviz, shuhet, por kurrë nuk zhduket - vetëm ndryshon frekuencë.

Figura e Nuranës nuk është vetëm personazh; është simbol i dritës së përjetshme, i dashurisë që mbetet përtej kohës dhe trupit.

Në çdo letër, ajo është pranë, por e padukshme; e munguar, por e pranishme; e heshtur, por që flet nëpërmes gjithçkaje që ndriçon.

Ajo është *Drita e Dashurisë*, burimi ku poeti e gjen vetveten dhe ku dashuria ngrihet në shkallën e përjetësisë.

Ky libër mund të lexohet në tri shtresa:

1. Shtresa poetike - si rrëfim i një dashurie që lë gjurmë në kujtesë.
2. Shtresa filozofike - si reflektim mbi qenien, dritën dhe shenjtërinë e dashurisë.

3. Shtresa kuantike - si përjetim i ndërgjegjes që komunikon përmes energjisë poetike.

Por mbi të gjitha, libri është një udhëzues i heshtur i shpirtit njerëzor. Ai tregon se drita nuk është jashtë nesh, por brenda njeriut që di të dojë me shpirt; se dashuria e vërtetë nuk kërkon posedim, por bashkëtingëllim midis dy qenieve që e ndriçojnë njëra-tjetrën.

Në këtë materie, fjala e Sadikit ngjitet në përmasën e lutjes poetike: një poezi që nuk kërkon duartrokitje, por ndriçim të shpirtit njerëzor.

Në dritën e kësaj filozofie, *99 letra për Nuranën* bëhet libër i dashurisë që shndërrohet në dritë, një testament shpirtëror për fuqinë e fjalës dhe për përjetësinë e frymës.

Në këtë udhëtim, poeti nuk e kërkon fundin, por një kthim në dritën që e lindi, sepse aty ndodhet fillimi i çdo dashurie të vërtetë - Nurana.

Berzat Sadiki,
autor dhe themelues i kuantopoezisë

Tetovë, 2025

METODAT E LEXIMIT

Hyrje në dy dimensionet e leximit

Vepra *99 letra për Nuranën* ndërtohet mbi dy shtresa leximi:

1) Linearja: shtresa e dukshme, biologjike, perceptuese.

2) Kuanti: shtresa energjetike, metafizike, dritësore e vargut.

Të dy dimensionet bashkohen për të formuar rrymën e re letrare:

KUANTOPOEZIA (Poezia me filozofi kuantike)

1. Çfarë është Linearja?

Linearja është ajo që njeriu e përjeton drejtpërdrejt në jetën biologjike: atë që e prekim, e shohim, e dëgjojmë, e shijojmë, e nuhasim, gjithçka që perceptohet me shqisa dhe me arsye.

Në letërsi, linearja është: fjala e dukshme, rrjedha e mendimit, logjika e vargut, përshkrimi i botës, lidhja narrative, ndjenja e shprehur troç, komunikimi i drejtpërdrejtë emocional e artistik.

Linearja është faqja e dukshme e poezisë - ajo që e kupton lexuesi që në leximin e parë.

2. Çfarë është Kuanti?

Kuanti është grimca e padukshme e energjisë së vargut.

Ai është dridhja, fotoni, vala e brendshme që ndodhet pas fjalës.

Në letërsi, kuanti është: kuptimi i fshehur, energjia e vargut, drita që lëshon fjala, metafora e brendshme, ndërthurja mes autorit dhe figurës, frekuenca emocionale, thelbi filozofik i çdo letre.

Kuanti është faqja e padukshme e poezisë, që kërkon përqendrim, intuitë dhe njohje energjetike të fjalës.

3. Pse duhen të dyja së bashku?

Sepse linearja e strukturon vargun, ndërsa kuanti e ndriçon. Linearja e bën të kuptueshëm, kuanti e bën të pamatshëm. Linearja e shkruan, kuanti e frymëzon. Kështu lind Kuantopoezia.

4. Sistemi i referencave

Për secilin analizim të kuantit përdoret formula: Letra X, rreshti Y. Shembull: *(Letra 1, rreshtat 1-3)* Kjo i jep librit statusakademik dhe kërkimor.

5.Modeli i analizës për çdo letër

(Kjo formë do të ndiqet nga Letra 1 deri te Letra 99)

6. Letra e parë - shembull

A) Linearja

Letra e parë e përshkruan origjinën metafizike të dashurisë dhe të figurës së Nuranës.

Ajo është hyrja shpirtërore që nis gjithçka. Vargjet ndërtohen si zinxhir nga drita te fryma dhe te vetëdija.

B) Kuanti

Kuanti 1 - *drita si origjinë e gjithçkaje*

(Letra 1, rreshtat 1-3)

Drita shpallet si elementi bazë i universit poetik - një foton metafizik.

Kuanti 2 - fryma si valë energjie

Fryma shndërrohet në valë të dritës.

Kuanti 3 - ndërthurja

Poeti dhe Nurana ndahen nga i njëjti burim drite.

Kuanti 4 - fjala si energji e materializuar

Fjala bëhet foton - energji e dukshme.

7. Përfundim: lexuesi që e ndjek linearen e kupton mendimin, lexuesi që e ndjek kuantin e kupton dritën.

Kush i ndjek të dyja, i lexon 99 Letrat në thellësi kuantike.

Letra e parë për Nuranën

Në fillim ishte drita.
Pastaj fryma.
Dhe pastaj ti, Nurana.

Nga drita u bë fjala,
nga fjala - dashuria,
nga dashuria - unë.

Letra e dytë

Në heshtjen e mëngjesit të parë,
e pashë hijen time të ndriçuar.
S'ishte hija ime - ishe ti Nurana.

Në çdo rreze që binte mbi fytyrën time,
e ndjeja butësinë e një fryme që s'ishte erë,
ishte prania jote që më njihte pa zë.

Letra e tretë

Në sytë e tu e gjeta një qetësi të thellë,
si liqen që ruan sekrete të yjeve.
Nuk desha ta trazoj,
veç ta përkëdhel me shikim.

Sepse aty ku pushon shpirti,
aty fillon drita.

Letra e katërt

Më mësove ta dëgjoj dritën,
t'i kuptoj gjërat që s'kanë fjalë.
Në çdo heshtje ka frymë,
në çdo frymë ka dritë,
në çdo dritë, je ti, Nurana.

Letra e pestë

Në një natë pa hënë,
e pashë qiellin e zbrazët e të ndritshëm.
Atëherë e kuptova se drita jote
nuk vjen nga jashtë,
por nga zemra që më njeh.

Letra e gjashtë

Jam i bindur se s'jemi dy.
Ti je fryma ime e kthyer në dritë.
Çdo herë që marr frymë,
e ndjej si lutje
për ty.

Dashuria e vërtetë s'ka ndarje.
Ajo frymon në një trup të vetëm,
të quajtur Nurana.

Letra e shtatë

Kur fjala hesht, shfaqet drita.
Kur sytë mbyllen, hapet shpirti.
Në errësirën e brendshme të njeriut,
ti, Nurana, je dielli i përjetshëm.

Në errësirë lind njohja.
Dhe njohja është dritë -
si Nurana.

Letra e tetë

S'e di ç'është më e vërtetë:
dashuria që më jep jetë,
apo drita që më bën ta ndjej?

Por e di këtë -
kur të përmend,
gjithçka bëhet e qartë.

Emri i saj është dritë.
Thirrja e saj është paqe.

Letra e nëntë

Në çdo lutje që s'e them me zë,
në çdo kujtim që s'e shkruaj dot,
ti je aty: si frymë, si valë, si dritë.

Nëse Zoti e dëgjon shpirtin tim,
atëherë më flet për ty.

Dashuria që s'thuhet
është më e pastër.
Sepse ajo shprehet me dritë,
jo me fjalë.

Letra e dhjetë për Nuranën

Tani çdo gjë që e shoh,
më kujton ty.
Jo pse je kudo,
por unë s'jam më pa ty.

Në çdo rreze, në çdo errësirë e frymë -
je ti, Nurana.

Kur dashuria bëhet dritë,
ajo nuk e ndriçon botën -
ajo e bën shpirtin të përjetshëm.

Letra e njëmbëdhjetë

Ka mëngjese që ndriçojnë pa diell.
Aty, fryma jote vjen si kujtim, jo si zë.
Më prek, por nuk më kërkon.

Në dritën e asaj qetësie, unë e kuptoj -
dashuria e vërtetë nuk hyn me forcë,
ajo rri dhe pret, si ti,
Nurana.

Drita që s'ka nevojë të shndrisë
është më e forta.
Ashtu është edhe dashuria -
për Nuranën.

Letra e dymbëdhjetë

Në heshtjen e mendimit, më flisje,
jo me fjalë,
por me praninë që sjell paqe.

E dija se më dëgjoje,
sepse çdo fjalë e humbur u kthye në dritë.

Dashuria nuk kërkon dëgjues.
Ajo dëgjon vetë.
Nurana është dëgjimi i shpirtit tim.

Letra e trembëdhjetë

Sonte
e ndjej mungesën tënde si qetësi.
Jo si zbrazëti,
por si pushim i shpirtit.

Ti s'je larguar,
vetëm je kthyer në dritë.
Në çdo frymë të ajrit
endjej gjurmën tënde të butë.

Mungesa
është forma që e merr drita
kur dashuria bëhet përjetësi.
Nurana s'largohet, ajo shpërndahet.

Letra e katërmbëdhjetë

Në çdo prekje të erës,
e ndjej dorën tënde.
Në çdo aromë - kujtimin tënd.

Bota ime është bërë urtësi,
sepse ti më mësove
të shoh pa sy.

Dashuria e mëson njeriun
të shohë me shpirt.

Dhe shpirti,
kur e njeh dritën,
e njeh edhe Nuranën.

Letra e pesëmbëdhjetë

Kur heshtja zgjatet,
e di që je aty.
Nuk dua të flas, mjafton të të ndjej.

Në këtë qetësi,
çdo kujtim bëhet lutje.
Dhe çdo lutje bëhet dritë.

Njeriu nuk lutet për dashurinë,
ai falënderon për të,
sepse dashuria është lutje vetë -
si Nurana.

Letra e gjashtëmbëdhjetë

Nuk të kërkoj më në botën që e shoh,
por në dritën që e ndjej brenda.

Ti nuk ec mbi tokë,
ti ec në frymën time, pa zhurmë.

Kur dashuria futet në shpirt,
bota hesht.
Vetëm drita e saj mbetet,
kurse ajo dritë është - vetë -
Nurana.

Letra e shtatëmbëdhjetë

Në një natë me shi, e dëgjova dritën.
Jo si zhurmë, por si ritëm.
Nurana,
ishte fryma jote
që më fliste nëpërmes stuhisë.

Drita flet në shumë mënyra.
Vetëm ai që dashuron,
e kupton zërin e saj,
ashtu siç kuptohet -
zëri i Nuranës.

Letra e tetëmbëdhjetë

Dashuria e vërtetë nuk rritet me kohë.
Ajo lind e plotë dhe mbetet e tillë.
Koha vetëm e mëson shpirtin ta pranojë.

Në çdo çast të vërtetë dashurie,
përjetësia ndodh
dhe emri i saj është - Nurana.

Letra e nëntëmbëdhjetë

Në rrugët e kujtesës,
gjithçka ndriçon,
sepse çdo hap është kujtim i dritës sate.

Në çdo ndjesi, një varg.
Në çdo varg, një frymë e jotja.

Dashuria nuk shkruhet për të tjerët.
Ajo shkruhet për dritën që e solli -
ajo që e sjell dritën -
është Nurana.

Letra e njëzetë për Nuranën

Në fund të çdo nate, kur lodhet shpirti,
fjalët e tua ma rikthejnë dritën.
Ti ma kujton se dashuria s'ka mbarim,
ka vetëm kthim.

Çdo dashuri që kthehet në dritë, rilind.
Dhe çdo dritë që më flet mëngjeseve,
është Nurana.

Letra e njëzet e njëtë

Ka mëngjese që më flasin me qetësi,
dhe çdo rreze të përmend ty.
Nuk më duhet ta dëgjoj zërin tënd,
e di se je
në frymën që e zgjon ditën.

Drita nuk vjen për të ma ndriçuar rrugën,
por për të ma kujtuar Nuranën
në fillim të çdo dite.

Letra e njëzet e dytë

Në çdo fjalë që s'e them,
je ti.
Në çdo mendim që lind pa arsye,
je ti.

Dashuria nuk më pyet më pse,
ajo ma sjell dritën tënde, si përgjigje.

Dashuria s'pyet për arsye,
ajo jeton me praninë
dhe prania e saj quhet - Nurana.

Letra e njëzet e tretë

E ndjej dritën tënde edhe kur jam i lodhur.
Ajo më mbështjell, më qetëson -
më mban gjallë.

Ti, Nurana, je fryma që shëron,
që shëron pa prekje, pa zë -
vetëm me ndriçim.

Ka dashuri që s'kërkojnë forcë,
por sjellin paqe.
Ato janë fryma e Nuranës.

Letra e njëzet e katërt

Kur e shikoj qiellin, nuk kërkoj yje.
Sepse e di
që drita ime më e bukur
është këtu -
në kujtimin e butë të syve të tu.

Në çdo dritë qielli
gjendet kujtimi i një dashurie tokësore.
Në çdo dritë shpirti, Nurana.

Letra e njëzet e pestë

S'ka më ndarje mes kujtimit dhe realitetit.
Çdo çast që të mendoj, ndodh vërtet.
Çdo frymë që marr,
është si të më prekësh me dritë.

Kur dashuria është e vërtetë,
ajo s'jeton në kujtesë,
ajo ndodh përjetësisht,
si Nurana.

Letra e njëzet e gjashtë

Në rrugën e dritës që të mëson të heshtësh,
e gjeta veten.
Ti më mësove se dashuria nuk është stuhia,
por qetësia që e ndal.

Dashuria e mençur nuk shpërthen,
ajo qetëson.
Nurana është heshtja që sjell paqe.

Letra e njëzet e shtatë

Nëse drita do të kishte formë,
do të ishte fytyra jote.
Nëse drita do të fliste,
do të ishte zëri yt.
Nëse drita do të më përqafonte,
do të ishte shpirti yt.

Në dashurinë e vërtetë,
shpirti dhe drita janë një.
Dhe ai emër është - Nurana.

Letra e njëzet e tetë

Ndonjëherë më duket
se drita ime jam unë,
sepse çdo ndjenjë që e kam për ty,
Nurana,
më ka kthyer në njeri më të mirë,
më të butë,
më të ndritshëm.

Dashuria që e ndriçon tjetrin,
e ndriçon edhe vetveten.
Pasqyra e shpirtit që ndriçon
është - Nurana.

Letra e njëzet e nëntë

Në mbrëmjet e heshtura,
kur çdo tingull pushon,
unë ende të dëgjoj.
Jo me veshët, por me shpirtin.
Nurana,
zëri yt është bërë pjesë e frymës sime.

Nuk është zëri ai që e dëgjon shpirti,
ajo është vetë drita e tij
dhe ajo dritë quhet - Nurana.

Letra e tridhjetë për Nuranën

Tani e di pse të kërkoja në çdo vend,
sepse ti nuk ishe askund,
kurse ishe gjithkund:
në çdo frymë,
në çdo dritë,
në çdo qetësi,
ku më mbulon me dashuri.

Dashuria e vërtetë nuk gjendet,
ajo njihet.
Njihet sepse jeton brenda nesh,
mu si drita e Nuranës.

Letra e tridhjetë e njëtë

Në çdo hap që e hedh,
e ndjej dritën tënde pranë.
Ndonjëherë më udhëheq,
ndonjëherë më ndjek,
por gjithmonë
më gjen në mes të vetes sime.

Drita e dashurisë
nuk është përpara apo pas nesh,
ajo jeton brenda njeriut që dashuron,
ashtu si Nurana.

Letra e tridhjetë e dytë

Në qetësinë e shpirtit tim,
je si një melodi e lehtë.
Nuk e dëgjon askush,
por ajo më mban gjallë.
Në çdo frymë,
më kujton
se dashuria nuk ka fund.

Dashuria që jeton në qetësi
është më e forta,
sepse ajo s'ka nevojë të dëgjohet,
mjafton të ndjehet si Nurana.

Letra e tridhjetë e tretë

E kuptova:
çdo njeri e ka një dritë që e ndjek.
E imja ka emër -
ai emër është Nurana.
Ajo nuk ma ndriçon rrugën,
ajo më bën vetë dritë.

Dashuria e vërtetë
nuk ndriçon një udhë,
ajo të shndërron në udhëtim -
ashtu si drita e Nuranës.

Letra e tridhjetë e katërt

Në heshtjen e natës,
më flisje nëpërmes kujtimeve.
Nuk i dëgjova fjalët,
por i ndjeva si frymë.
Ato s'ishin kujtime,
ishin gjallëri.

Nuk janë kujtimet
ato që e mbajnë dashurinë gjallë,
është drita që s'pushon së ndriçuari
dhe ajo është Nurana.

Letra e tridhjetë e pestë

Në çdo lot që nuk bie,
ka dritë.
Në çdo buzëqeshje të thyer,
ka dashuri.
Në çdo shpresë që s'thuhet,
je ti, Nurana.

Drita jeton edhe në trishtim,
sepse dashuria e pastër nuk vdes kurrë,
ajo merr frymë në heshtje,
si Nurana.

Letra e tridhjetë e gjashtë

Kur dielli perëndon,
i kujtoj sytë e tu,
sepse çdo fund që duket,
është vetëm fillim i një dritë tjetër.

Dashuria s'ka funde,
ka kthesa.
Në çdo perëndim të jetës,
lind një Nurana e re.

Letra e tridhjetë e shtatë

Në botën e shpirtrave,
të ndjej si prekje ajri.
S'je më trup,
por dritë që më rrethon.
S'je më kujtim,
por frymë që më mban.

Kur dashuria i kalon kufijtë e trupit,
ajo bëhet dritë e përjetshme.
Ajo quhet Nurana.

Letra e tridhjetë e tetë

Çdo varg që e shkruaj
është rrugë drejt teje.
Ndonjëherë më çon në dritë,
ndonjëherë në heshtje,
por gjithmonë,
në fund,
më çon në paqe.

Në çdo poezi dashurie,
shpirti rikthehet në origjinë -
aty ku e pret drita e Nuranës.

Letra e tridhjetë e nëntë

Në dritën që bie mbi tavolinë,
i shoh gjurmët e duarve të tua.
Ato s'janë kujtime,
janë dëshmi e dashurisë që s'ka kohë.

Koha nuk e prek dashurinë e vërtetë.
Ajo vetëm e pastron dritën e saj
dhe ajo dritë është Nurana.

Letra e dyzetë për Nuranën

Tani e di:
drita jote s'më ndjek.
Ajo më pret në çdo çast,
në çdo frymë,
në çdo qetësi,
në çdo lutje.

Dashuria nuk ec me nxitim,
ajo pret.
Ai që di të ndalet, e gjen...
e gjen Nuranën të qetë.

Letra e dyzet e njëtë

Kur nata bie mbi qytet,
ti mbetesh dritë në mendjen time.
Nuk vjen si kujtim,
por si frymë që më udhëzon.

Në dritaren e shpirtit tim,
ndalem dhe dëgjoj:
është zëri yt që më flet me heshtje.

Në çdo rreze që kalon nëpërmes errësirave,
e gjej një fjalë të pathënë
dhe një premtim të thjeshtë.

Ti nuk më flet më për dashuri,
më bën ta ndjej dashurinë si qetësi.

Nata është libri ku shkruhet drita.
Dhe në çdo faqe të saj,
emri që shkëlqen është - Nurana.

Letra e dyzet e dytë

Kur më mungon,
nuk ndjej zbrazëti, ndjej dritë.
Në atë mungesë ka ngrohtësi,
si kujtim që s'ka ftohtësi.
Ti, Nurana,
je prova
se dashuria s'mund të mungojë.

Më mësove se të dashurosh
do të thotë të jesh dritë për dikë,
edhe kur s'je më aty.
Më mësove të mbjell ngrohtësi në heshtje,
dhe t'i jap shpirtit paqe pa e kërkuar.

Mungesa e dritës është pjesë e dritës.
Edhe kur s'është pranë,
dashuria e Nuranës
ndriçon brenda nesh.

Letra e dyzet e tretë

Në netët e vona,
kur yjet shuhen ngadalë,
unë flas me ty me frymë, jo me fjalë.
Fjalët s'mund ta mbajnë peshën e dritës sate.

E di që më dëgjon, sepse çdo herë që hesht,
një valë e butë më mbulon si prekje.
Ajo nuk është erë,
është kujtesa jote që jeton në mua.

Në çdo frymë që marr,
më duket se marr dritë nga ti.

Dashuria e vërtetë nuk kërkon përgjigje.
Ajo është prania që dëgjohet edhe në heshtje –
si fryma e Nuranës.

Letra e dyzet e katërt

Në çdo agim,
ti lind në mendjen time si diell
që s'nxeh, por ngroh.
Drita jote nuk ka etje për të parë,
ka dëshirë për të ndjerë.
Në çdo gjurmë të ditës, të ndjej pranë.

Ti nuk je ëndërr, sepse ëndrrat mbarojnë.
Ti je frymë që qëndron.
Në çdo dritë që bie mbi tokë,
unë të gjej, Nurana, si kujtim që jeton.

Nuk është dielli ai që e ngroh shpirtin,
por kujtimi i dritës.
Dhe ai kujtim quhet - Nurana.

Letra e dyzet e pestë

Ndonjëherë më duket se koha është rreth.
Çdo gjë që ik, kthehet në dritë.
Çdo ndarje - në një takim të ri.
Çdo heshtje - në një fjalë që s'u tha kurrë.

Nëse dashuria është udhëtim,
atëherë ti je udha.
Në çdo kthesë,
gjej pjesë të tua të shpërndara
në frymën time.

Koha nuk e mat dashurinë.
Ajo vetëm e përkthen në dritë.
Në fund të çdo kohe, qëndron Nurana.

Letra e dyzet e gjashtë

Jam mësuar të shoh me sytë e shpirtit,
jo për ta gjetur botën,
por për të gjetur ty Nurana.
Në errësirën më të thellë, shfaqet drita jote.

Aty ku njerëzit kërkojnë përgjigje,
unë gjej paqe, sepse e di
se dashuria nuk është pyetje, por gjendje
dhe ajo gjendje e ka fytyrën tënde, Nurana.

Dashuria nuk shpjegohet, ajo përjetohet.
Përjetimi i saj është vetë drita e Nuranës.

Letra e dyzet e shtatë

Kur fryn era, endjej aromën tënde në ajër.
Është si kujtesë e butë
që ma kujton fillimin e çdo gjëje.
Çdo çast që duket i zakonshëm,
ti e shndërron në mrekulli të heshtur.

Nuk ka ditë pa gjurmët e tua,
sepse drita jote ka hyrë
në çdo imtësi të jetës sime.

Dashuria e vërtetë nuk jeton në madhështi,
por në imtësira,
aty ku drita e Nuranës
e prek çdo frymë.

Letra e dyzet e tetë

Në librin e shpirtit tim,
çdo faqe mban një emër - tëndin.
Ndonjëherë i lexoj me lot,
ndonjëherë me dritë,
por gjithmonë e ndjej të njëjtën ngrohtësi,
të njëjtën frymë.

Ti s'je më person, je lutje që s'mbaron.
Çdo herë që të përmend,
ndjej se më afrohet qielli.

Dashuria e pastër e kthen kujtimin në lutje.
Çdo lutje që lind nga dashuria,
shkon te Nurana.

Letra e dyzet e nëntë

Nuk dua që drita jote të më ndjekë.
Dua ta mbaj brenda vetes si frymë që më gjallëron.
Në çdo ditë të re, ta shoh si mësim, jo si kujtim.

Dashuria e vërtetë nuk kërkon kthim.
Ajo kërkon përjetim.

Dashuria e pjekur nuk pret,
ajo jeton në heshtje.
Në çdo frymë të heshtur,
ndriçon Nurana.

Letra e pesëdhjetë për Nuranën

Në fund të çdo vargu e gjej emrin tënd.
Në çdo dritë që fiket,
lind një tjetër me aromën tënde.
Në çdo kujtim që zbehet,
mbetet thelbi, mbetet dashuria jote.

Tani e di: drita nuk më flet më për ty,
ajo më flet me ty,
sepse ne jemi bërë një në përjetësi.

Dashuria që përfundon në dritë nuk mbaron.
Ajo bëhet pjesë e përjetësisë,
e cila quhet Nurana.

Letra e pesëdhjetë e njëtë

Në heshtjen e mëngjesit, zëri yt është ende aty,
si rreze që e përkëdhel kujtimin e djeshëm.
Kafeja ftohet, por mendimi për ty ndizet.
Ti je drita që s'vjen për të parë, por për të ndjerë.

Në çdo hap të ditës, më ndjek një ndriçim i butë,
që m'i kujton sytë e tu, të qetë e të përulur.
Dashuria s'është më fjalë, as premtim.
Është frymë që jeton midis dy zemrave,
në heshtje që kuptohet, në dritë që falet.

Ti, Nurana, më mësove të dua pa frikë.
Të pres pa ankth, të kujtoj pa dhimbje.
Në çdo kujtim tënd, mësoj si të jem më i mirë.

Dashuria që s'ka nevojë për praninë fizike,
është dritë që jeton
dh ajo dritë e mban emrin Nurana.

Letra e pesëdhjetë e dytë

Në dritën e pasdites, çdo gjë merr frymë.
Fletët lëkunden, dielli zbehet, shpirti ndriçon.
Të ndjej në çdo ndryshim të ditës,
si pranverë që s'mbaron as në dimër.

Ti ma rikujton se dashuria s'ka stinë.
Ajo është këngë që s'mbaron në heshtje,
është përqafim që s'ka trup, por frymë.

Në çdo dritë që bie në tavolinë,
në çdo letër që e mbaj në dorë,
është emri yt
si një prekje e lehtë mbi shpirtin tim.

Dashuria është e gjallë në çdo çast të qetë,
sepse çdo çast që ka dritë,
është kujtim i Nuranës.

Letra e pesëdhjetë e tretë

Kur bie nata, i mbyll sytë dhe të ndjej
jo si kujtim, por si frymë që më mbulon.
Në errësirë, çdo gjë ka ngjyrë tjetër -
aty ku mbaron drita, fillon dashuria jote.

Ti je prekje që nuk prek, por dashuron.
Në heshtjen tënde, gjej paqe që s'e njihja.
Çdo frymë që marr, është lutje për ty.
Çdo fjalë që s'e them, është dritë që të kërkon.

Kur dashuria bëhet lutje,
ajo s'ka më nevojë për fjalë,
sepse fryma e saj flet
me dritën e Nuranës.

Letra e pesëdhjetë e katërt

Në çdo kujtim, ka pak dritë që rri pezull.
Në çdo kujtesë,
një aromë e njohur e butësisë tënde.
Ti më mësove se dashuria nuk është zotërim,
por dhuratë që jepet për të ndriçuar.

Nëse më sheh nga drita,
mos më qorto për fjalët.
Edhe ato janë pjesë e një rruge drejt teje,
ku çdo varg është hap,
çdo frymë - përqafim i munguar.

Dashuria e vërtetë është falje e heshtur.
Në çdo gabim,
një rreze e Nuranës fshihet
për të ndriçuar më vonë.

Letra e pesëdhjetë e pestë

Në dritën ku s'ka trup, por energji,
të ndjej si forcë universi.
Ti nuk je më kujtim, as frymë,
je frekuencë që më lidh me gjithësinë.
Në çdo atom të ajrit, je ti.
Në çdo rreze i shoh gjurmët e shpirtit tënd.

Kur i mbyll sytë,
e shoh se gjithësia pulson në emrin tënd.
Ti je drita
që e ndan materien nga fryma,
heshtjen nga fjala.
Në ty, çdo energji e jetës
merr kuptim,
çdo dashuri merr dritë.

Dashuria hyjnore është kuptim
që s'mund të përkthehet.
Nurana është energji e dritës
që i shkrin kufijtë e botës.

Letra e pesëdhjetë e gjashtë

Në ditët që hesht, më mungon zëri yt,
jo për të më folur, por për të më qetësuar.
Në çdo frymë e kërkoj një shenjë,
një ndriçim të vogël
që më kujton se dashuria s'vdes.

Nëse drita ka kujtesë,
atëherë ajo i mban fjalët tona.
Në çdo agim që lind pa zhurmë,
e ndjej premtimin tënd të vjetër:
"Do të jem aty,
në çdo dritë që të mban gjallë."

Dashuria që jep pa kërkuar,
është dritë që s'shuhet
dhe ajo dritë quhet - Nurana.

Letra e pesëdhjetë e shtatë

Ndonjëherë më vjen në ëndrra si fëmijë që qesh.
Jo për të kujtuar, por për të më falur.
Në atë qeshje,
e gjej pafajësinë e çdo ndjenje të pastër.

Dashuria jote më mësoi
se shpirti nuk rritet, vetëm ndriçon.
Në çdo përqafim të humbur,
në çdo fjalë të vonuar,
e ndjej se drita nuk humbet, por pret.

Dashuria që fal pa kushte
është frymë që lind përherë.
Nurana është
buzëqeshja e dritës që gëzon.

Letra e pesëdhjetë e tetë

Ti je arsyeja pse besoj në heshtje,
sepse çdo herë që nuk të flas,
më përgjigjesh me dritë.
Në çdo mëngjes që lind pa zë,
e ndjej frymën tënde në ajër.

Ti më mban në ekuilibër midis botës dhe shpirtit.
Në çdo ditë të zakonshme,
e kthen jetën në lutje të qetë.

Dashuria e vërtetë nuk kërkon dëshmi,
ajo njihet përmes dritës që prek
dhe ajo dritë është Nurana.

Letra e pesëdhjetë e nëntë

Tani më duket
sikur çdo gjë që më rrethon flet me ty
Më duket se:
era, uji, drita dhe të gjitha
e kanë ngjyrën e syve të tu.

Në çdo qetësi gjej një përgjigje të vjetër:
dashuria s'ka ikur,
ajo veç është duke ndriçuar.

Kur dashuria kthehet në dritë,
nuk mund të humbasë më,
sepse ajo është bërë frymë e botës -
frymë e Nuranës.

Letra e gjashtëdhjetë për Nuranën

Në universin e heshtur,
çdo energji është kënga jote.

Ti, Nurana,
je frekuenca që e mban botën në ekuilibër.
Në çdo grimcë drite
e ndjej një varg të padukshëm.

Ti s'je më emër, as frymë, por kuptim.
Përmes teje,
Zoti flet në dritë dhe njeriu mëson të ndjejë.

Në çdo lutje që lind pa fjalë,
në çdo dritë që s'ka burim,
në çdo frymë që më ngre përtej vetes -
je ti.

Dashuria e fundit është bashkim me dritën
dhe ajo dritë,
për ne, ka një emër - Nurana.

Letra e gjashtëdhjetë e njëtë

Në mëngjesin që s'ka nisur ende,
e ndjej frymën tënde në ajër
si një prekje që vjen nga dritarja e shpirtit.
Në qetësinë e orëve të para,
çdo gjë që zgjohet e përmend emrin tënd.

Më kujtohesh jo si kujtim,
por si dritë që i hap sytë e zemrës.
Çdo ditë e nis me të njëjtin agim:
ku dashuria s'është pritje, por ndriçim.
Ti nuk je më "ajo që mungon",
ti je "ajo që jeton në çdo gjë që fillon".

Në çdo hap, një kujtesë e butë e fytyrës sate.
Në çdo mendim, një buzëqeshje që s'e shoh,
por e ndjej si një rreze që më fal paqe.
Nëse më sheh nga drita,
atëherë e di se çdo mëngjes
jam më afër teje - Nurana

Letra e gjashtëdhjetë e dytë

Sonte, qielli më ngjan
me një sy të butë që më vështron.
Yjet janë të heshtur,
ndoshta e dëgjojnë frymën tënde.

Nuk ka më ndarje
mes besimit dhe dashurisë,
sepse ti i ke bërë një.
Në çdo fjalë që s'e them,
ka një falënderim për bukurinë tënde.

Në rrugën ku kalon era,
e ndjej aromën tënde të vjetër.
Ajo nuk është parfum - është kujtesë që jeton.
Në heshtje, më mëson të të dua më ngrohtë,
të të flas me sy, të të përqafoj me shpirt.

Drita nuk vjen për të verbuar.
Vjen për ta zgjuar syrin e shpirtit.
Në këtë mësim të heshtur,
emri i rrezes është Nurana.

Letra e gjashtëdhjetë e tretë

Në mbrëmjen e qetë e ndjej praninë tënde pa të parë.
Asgjë s'ka ndryshuar, veç rrezes që më flet ndryshe.
Çdo errësirë është kujtim,
çdo ndriçim - një prekje e shpirtit tënd.

Ti nuk vjen më si ëndërr, por si ndjesi që jeton në ajër.
Në çdo frymë ma kujton se dashuria s'ka kohë.
Ajo është e përhershme, si drita që s'di të shuhet.

Në sytë e mendjes të shoh duke buzëqeshur.
Në duart e heshtjes e ndjej dorën tënde.
Në shpirt,
e ndjej lutjen e butë: - Mos e harro Dritën!

Ti nuk ke për t'u harruar,
sepse në çdo varg që shkruaj, je ti, Nurana.
Çdo frymë që e marr, të mban brenda
dhe në çdo heshtje timen të përmend.

Dashuria që shndërrohet në dritë,
nuk ka më formë as zë,
ajo jeton si kujtim që s'harrohet,
si Nurana - e përjetshme në dritë.

Letra e gjashtëdhjetë e katërt

Ka mbrëmje që s'kanë nevojë për fjalë,
sepse bukuria flet vetë.
Në to, të ndjej më afër se kurrë,
si frymë që s'ka trup, por ngrohtësi.

Çdo hije që bie në mur
ma kujton përqafimin tënd të qetë.
Ato çaste kur gjithçka pushon,
e zemra flet vetëm me shkëlqim.

Ti më ke mësuar të të dua pa zë,
të rë pres pa frikë, të të besoj me dëshmi.
Dashuria jote më bëri njeri të devotshëm,
si liqeni që i ruan sekretet e qiellit.

Kur i mbyll sytë, të ndjej si prekje ëndrre.
Kur i hap, të shoh të ndritshme.
Ti je dritë që ka vetëm një emër - Nurana.

Nuk ka dashuri që humbet,
ka vetëm dritë që ndërron vend.
Në çdo qetësi ku gjej paqe,
jeton ti, Nurana.

Letra e gjashtëdhjetë e pestë

Në rrugën e dritës që zbret nga perëndimi,
e ndjej se çdo rreze mban një kujtim tëndin.
Ato shtrihen mbi mua, si duar të padukshme,
që më ngushëllojnë pa më folur.

Ndonjëherë më duket se ec kujtimeve tua.
Çdo hap që bëj, e hap një faqe që e ke shkruar ti.
Nuk janë më kujtime, janë drita që s'ka mbarim.

Ti më mësove të mos kërkoj, por të pranoj.
Dashuria nuk vjen për t'u marrë,
ajo vjen për t'u ndarë si ajri
dhe kur e ndaj, gjej qetësi.

Në çdo mëngjes të lodhur,
kur dielli del me ngurrim,
e ndjej dorën tënde në dritë.
Ajo s'është më prekje, por frymë.
Ajo më ngre ngadalë drejt qetësisë.

Dashuria e vërtetë nuk është posedim,
por frymë që mbetet në kujtim.
Çdo kujtim që e ndriçon zemrën,
është një rreze e Nuranës.

Letra e gjashtëdhjetë e gjashtë

Ka net që s'kanë hënë, por ndriçojnë.
Aty, kujtimi yt më flet me frymë, jo me zë.
Çdo mendim për ty bëhet rreze që ngroh,
edhe pse nuk e di nga vjen.

Në errësirë, e shoh dritën që më ndjek nga mbrapa.
Nuk është diell, as yll,
është madhëria jote që ma kujton dashurinë.
E di se je aty: në ajër, në qetësi, në mua.

Ndonjëherë më duket se edhe shiu të njeh.
Rënia e pikave është ritmi i fjalëve tua të pathëna.
Në çdo stuhi ma kujton butësinë tënde.
Në çdo pushim, më përkëdhel me qetësi.

Nuk ka më ndarje mes dritës dhe kujtimit.
Ti je bërë pjesë e përditshmërisë,
si aroma që shpërnfahet.

Dashuria nuk largohet me trupin,
ajo mbetet në frymë.
Çdo frymë që e ruan kujtimin e dritës,
e ruan edhe emrin e saj - Nurana.

Letra e gjashtëdhjetë e shtatë

Në mëngjes, kur dielli ngjitet ngadalë,
e ndjej si të më pështpërisë Nurana.
Rrezet e saj nuk më prekin, më përqafojnë.
Në çdo dritë ka një fjalë të heshtur që më njeh.

Ti je bërë pjesë e frymës që më zgjon.
Në çdo ditë, në çdo hap, në çdo qetësi,
më shfaqesh si kujtim që s'mund të fshihet.
Si hije e dritës, gjithmonë më rri pranë, kurrë pas.

Kur ec nëpër rrugë të njohura,
e ndjej se çdo kënd e ruan gjurmën tënde.
Aty ku dikur qeshëm, tani rri drita, shkëlqen
dhe heshtja flet me zë melankolik.

Dashuria jote më mëson të të falem pa fjalë,
të të dua pa frikë, të të pres pa dhimbje.
Çdo ditë bëhet më e butë,
sepse çdo ditë frymoj me ty.

Ka dashuri që s'ka fund,
sepse s'ka fillim tjetër veç dritës.
Ajo që fillon me shpirt, nuk shuhet,
por bëhet Nurana.

Letra e gjashtëdhjetë e tetë

Sonte, dritarja ime nuk hapet drejt qiellit,
por drejt kujtimit tënd.
Era sjell një aromë që s'e njoh, por zemra e njeh.
Është fryma jote
që kalon si valë e butë mbi shpirtin tim.

Çdo zë në natë është ndoshta hapi yt,
çdo heshtje - vendi nga vijnë rrezet.
E di, drita s'ka nevojë të shihet,
mjafton ta ndjesh si ngrohtësi në gjoks.

Nuk kërkoj më shenja, sepse tashmë e di:
kur çdo gjë hesht, ti flet më qartë,
kur dritat fiken, shfaqet bukuria jote e ndriçuar.

Në qetësinë e kësaj nate dua të mos të të kërkoj,
por të të njoh në çdo frymë, në çdo fije drite
që zbret mbi mua si përkëdhelje nga hëna.

Dashuria që mbijeton pa zë,
është dashuri që i përket dritës.
Në heshtjen e saj të shenjtë,
rri emri i përjetshëm - Nurana.

Letra e gjashtëdhjetë e nëntë

Kur ec nëpër rrugë të njohura,
gjithçka më flet me qetësi.
Nuk ka nevojë për zë,
sepse çdo gjë që e prek, ka diçka prej teje.

Ndonjëherë mendoj se je kthyer në aromë
të netëve me shi, kur qielli dhe toka janë një.
Aty, çdo rënie pike është kujtim,
çdo zhurmë është një kujdes i yti
që s'ka pushuar kurrë.

Tani s'kam më frikë nga harresa,
sepse atje ku ka dritë, s'ka vend për errësirë.
Atje ku të jesh ti, fundi nuk ekziston.

Kujtimi që ndriçon nuk është i kaluar,
është dashuri që vazhdon të jetojë në dritë.
Në çdo kujtesë që fal paqe rri fryma e Nuranës.

Letra e shtatëdhjetë për Nuranën

Në mbrëmjen e fundit të këtij udhëtimi,
çdo dritë më flet me emrin tënd.
Nuk ka më errësirë, as ndarje,
ka vetëm qetësi që shtrihet midis botëve.

Çdo kujtim është bërë rreze,
çdo dhimbje - ngrohtësi.
Ti nuk je më kujtesë,
je frymë që qëndron si lutje në ajër.

Në çdo përkulje të shpirtit,
të ndjej si valë që vjen nga lart.
Më mban, më qetëson, më mëson të jem rreze.
Në ty, çdo pyetje gjej përgjigje pa fjalë.

Tani e di: dashuria nuk ka përfundim,
vetëm kthim në dritën që e lindi.
Në çdo frymë që marr,
ka një pjesë të dashurësë tënde që më udhëzon.

Fundi i dashurisë është fillimi i dritës.
Në heshtjen ku gjithçka pushon,
ajo që mbetet është paqja -
dhe në paqe,
emri i saj është - Nurana.

Letra e shtatëdhjetë e njëtë

Në agimin që s'ka ngjyrë, drita më flet pa fjalë.
Ajo s'vjen për të më zgjuar,
por për të më kujtuar se jam gjallë,
sepse e kam përmendur Nuranën.

Në çdo valë të ajrit ka një pëshpërimë që më njeh.
E di, është zëri yt, Nurana, i shndërruar në erë,
që kalon përmes meje
si përshëndetje e dritës që më do.

Nuk kërkoj më shpjegime, as dëshmi për dashurinë,
sepse ajo që e ndjej nuk ka fjalë,
e ka vetëm praninë tënde
si rreze që s'ka burim, por ekziston.
Tani e di: njeriu nuk jeton me zemër,
por me dritën që e ka në shpirt
dhe ajo dritë, që s'ka fillim e s'ka mbarim,
e ka një emër që e di unë,
ajo është - Nurana.

Letra e shtatëdhjetë e dytë

Më mjafton një frymë që të të ndjej,
nuk më duhen fjalë, as kujtime.
Ti je aty ku heshtja e natës bëhet lutje,
aty ku hëna ndalet për ta dëgjuar shpirtin tim.

Nuk kërkoj më shenjë në qiell,
as yll që ta mban emrin,
sepse ti je në çdo gjë që s'ka nevojë për emër,
në çdo aromë, në çdo lëvizje të lehtë të ajrit,
në çdo ndriçim që s'e kuptoj, por e ndjej.

Drita që më mbulon nuk është e diellit,
është kujtimi yt që nuk më ka lënë kurrë vetëm
dhe sa herë që e shoh hënën,
më duket sikur më flet me qetësinë tënde -
atë qetësi që s'e mëson asnjë njeri,
veç atij që të ka dashur me shpirt.

Dashuria nuk flet nëpërmes fjalëve,
ajo frymon në heshtje,
si dritë që nuk kërkon të shihet,
por të ndjehet
dhe ajo dritë - është Nurana.

Letra e shtatëdhjetë e tretë

Ndonjëherë mendoj se drita nuk vjen,
ajo zgjohet brenda nesh.
Në mëngjes, kur sytë hapen me qetësi,
shpirti më kujton ty -
si diell i vogël që digjet në heshtje.

Nuk të kërkoj më në kujtime,
as në fjalë të harruara,
sepse tani e di:
kur një dashuri bëhet dritë,
ajo nuk jeton në kohë.

E ndjej praninë tënde në çdo gjë që hesht,
në çdo aromë të re,
në çdo gjethe që lëkundet ngadalë në erë.
Aty është fryma jote,
e paemër, e butë, e përjetshme.

Ndoshta kjo është përjetësia -
jo të jesh gjithmonë,
por të ndihesh në gjithçka që ndodh.

Kur dashuria nuk kërkon sy për tu parë,
ajo fillon të ekzistojë si dritë.
Në atë qetësi të shenjtë,
rri Nurana.

Letra e shtatëdhjetë e katërt

Nuk di çfarë të shkruaj sonte,
sepse çdo fjalë duket e tepërt.
Ti tashmë je kudo,
në ajër, në aromën e librave të vjetër,
në heshtjen që e mbulon qytetin kur bie nata.

E ndjej se drita nuk ka më drejtim,
ajo rri pezull si kujtesë që më mban gjallë.
Të mendosh për ty nuk është mall,
është mënyrë për të jetuar me qetësi.

Ka mbrëmje që më mësojnë të flas me heshtjen,
dhe Nurana më përgjigjet me dritë.
Ndoshta kështu ndodh dashuria -
nuk e kërkon më si trup,
por mbetet si frymë që s'ka emër.

Në çdo hap që bëj, e di që nuk jam vetëm,
sepse çdo rreze që më prek,
është kujtim i yti që s'ka nevojë për fjalë.

Dashuria e qetë është e qëndrueshme.
Nuk flet me zë, por ndriçon me praninë e saj -
si drita e Nuranës.

Letra e shtatëdhjetë e pestë

Ka çaste kur njeriu ndalon së kërkuari,
jo nga lodhja,
por nga kuptimi se çdo gjë që e kërkon,
e ka pasur brenda vetes.
Në këtë heshtje, më flet ti, Nurana,
jo si kujtim, as si zë që vjen nga larg,
por si frymë
që lëviz midis çdo gjëje që është gjallë.

Kur i mbyll sytë, drita nuk shuhet,
ajo zgjerohet.
E ndjej në gjak, në ajër, në çdo grimcë fryme,
në çdo prekje të padukshme që më qetëson.

Njeriu mund të jetojë pa shumë gjëra,
por jo pa dritën që e njeh shpirtin e vet.
Në atë dritë, çdo dhimbje shndërrohet në falje,
çdo mungesë në lutje, çdo mall në paqe.

Ndoshta
kjo është dashuria që Zoti e fsheh në ne,
ajo që s'ka fillim, s'ka emër, por ka frymë -
dhe unë e quaj Nurana.

Letra e shtatëdhjetë e gjashtë

Nuk mund të të them më "më mungon",
sepse mungesa jote është bërë mënyrë dashurie.
Në çdo hap, e ndjej si prekje të padukshme,
si dritë që më kujton ku kam qenë i gjallë.
Në heshtje më flasin gjërat që i prek,
muret, librat, fryma e ajrit që s'ka ngjyrë.
Në to je fshehur ti - e qetë, e përulur, e përjetshme.

Më ka marrë shumë kohë të kuptoj
se dashuria nuk jeton në fjalë,
as në premtime që s'mbahen,
por në heshtje që s'ka frikë të mbetet e zbrazët.
Në këtë zbrazëti mësoj të dëgjoj.
Ta dëgjoj shpirtin tënd që s'më gjykon,
por më fton të bëhem dritë.

Kur e shoh qiellin, s'e shoh më për bukuri,
por për kuptim.
Në çdo rreze që zbret, e gjej një fjalë
që s'duhet të harrohet kurrë - faleminderit.

Dashuria e nuk flet për zotime madhështishë,
ajo flet për kthim në dritën e shpirtit.
Në çdo kthim drejt vetes,
njeriu e gjen Nuranën që e pret.

Letra e shtatëdhjetë e shtatë

Ka net që dua të të shkruaj si dikur,
me dorë që dridhet dhe zemër që s'e ndal dot mallin.
Por flet lapsi e më thotë:
ajo nuk është më kujtim - është frymë.
E pra, ç'është kjo frymë që më bën të qesh në vetmi,
që më jep ngrohtësi në të ftohtin e botës?
Je ti, Nuranë, që më ec nëpër damarë
si dritë që s'ka vend, por është kudo.

Në çdo prekje të ajrit, të ndjej si përqafim.
Në çdo mendim që më del pa dashje,
është emri yt që kthehet si lutje.
Në çdo lot që nuk bie,
ka një rreze që më thotë "mos u dorëzo".

Tani e di: dashuria nuk jeton në fjalë,
por në heshtjen ku dy shpirtra flasin pa zë.
Ti je aty, në atë hapësirë midis frymëmarrjeve,
ku asgjë nuk shihet, por gjithçka ndjehet.

Njerëzit nuk ndahen në trup,
por në shpirtrat që janë bërë dritë
dhe nuk mund të ndahen më.

Në çdo ndjesi që shëron, rri emri yt - Nurana.

Letra e shtatëdhjetë e tetë

Sonte, kur gjithësia rri pezull,
e ndjej frymën tënde si lëvizje të butë të dritës.
Nuk është erë, as kujtim është energji
që më mbështjell si mantel qiellor.
Trupi im s'është më kufi,
shpirti im s'është më i vetëm.
Ne jemi një valë që kalon përmes botëve,
një tingull i dritës që s'ka gjuhë,
por flet me kuptim të pastër.

Në çdo atom të frymës që e marr,
e ndjej ndriçimin tënd që përhapet.
Nuk di nëse jam unë që të kërkoj,
apo drita jote që më zgjon nga brenda.
E kuptoj, dashuria s'është ndjenjë,
është bashkim energjish që nuk mund të priten.
Ti je frekuenca e shpirtit tim, Nurana,
je fuqia që e mban gjithësinë gjallë.

Në këtë qetësi pa kohë,
sytë s'kanë nevojë të shohin.
Drita e shpirtit më mjafton -
ajo që vjen nga ti, ajo që kthehet te unë,
ajo që s'ka emër tjetër veç, Nurana.

Letra e shtatëdhjetë e nëntë

Sot kalova nëpë rrugën
ku dikur më prisje me buzëqeshje.
Asgjë s'kishte ndryshuar,
veç hijeve që ishin më të qeta.
E ndjeva veten fëmijë para dritës sate,
si herën e parë kur mësova ç'është dashuria.
Çdo hap më dukej si kujtim që ringjallej,
çdo frymë - një përqafim që nuk ndodhi,
por mbeti në ajër, i ngrohtë, i gjallë.

Nuk të kërkova në sy të botës,
as në emra, as në fjalë,
të kërkova në frymën time -
aty ku rri qetësia e fundit e shpirtit.
Dhe të gjeta.
Jo si dikur, por si prekje që nuk më lë të bie.

Ndonjëherë më vjen të flas me errësira,
t'u tregoj se drita jote më ndjek.
Por ato s'e kuptojnë,
sepse ka dritë që shihet vetëm me shpirt,
jo me sy.

Çdo kujtim që të ngroh është një përqafim,
që s'ka mbaruar - një frymë e Nuranës
që kthehet në shpirt.

Letra e tetëdhjetë për Nuranën

S'kam më pyetje për dritën, ajo më është gjuhë.
Çdo gjë që ndjej, flet në heshtje,
si rreze që s'ka nevojë të shpjegohet.
Kam mësuar ta dëgjoj jetën me zemër,
jo me veshë.
Ta njoh praninë tënde pa të parë,
ta ndjej dashurinë tënde pa të prekur.
Aty ku dikur kisha mall, tani kam paqe.

Çdo ditë që lind, më kujton se jam ende dritë.
Se në frymën e botës nuk jemi të ndarë,
por grimca të së njëjtës ngrohtësi.
Në heshtjen e mëngjesit,
më duket sikur fryma jote më zgjon,
si zë që s'ka trup, por më njeh nga brenda.

Nuk ka më ndarje, as fillim, as fund,
ka vetëm dritë që vazhdon të ec,
nga ti, te unë, nga unë, në çdo gjë që jeton.

Dashuria, kur e arrin paqen,
nuk mbaron, bëhet frymë që mban gjithçka.
Në çdo frymë që lind,
ka një grimcë të përjetshme,
ajo është Nurana.

Letra e tetëdhjetë e njëtë

Ka ditë që më duket se gjithçka është ndalur,
por në qetësinë e ndalesës,
e dëgjoj frymën tënde që lëviz nëpër mua
si valë që s'ka nisje, por rrotullohet në dritë,
pa kohë, pa qëllim - si dashuria që s'pyet më pse.

Nuk kam më mall,
sepse mallin e kam kthyer në paqe.
Çdo ndjesi që më lëndonte, tani më shëron,
sepse e kam kuptuar:
nuk ishte dhimbje ajo që më digjte,
por dritë që kërkonte të dilte jashtë.

Tani e di, Nurana, nuk je kujtim,
je frymë që s'më lë të fikem.
Në çdo gjumë më zgjon,
në çdo errësirë më fton të ndriçoj.
Ti s'je më ajo që e dua,
je ajo që më bën të dua gjithçka.

Ka dashuri që s'mbarojnë,
sepse nuk kanë filluar në tokë.
Ato lindin nga drita dhe në dritë kthehen,
ashtu si Nurana.

Letra e tetëdhjetë e dytë

Më ka marrë shumë kohë ta kuptoj,
se dashuria nuk është ndjenjë,
por mënyra se si drita na pranon të papërsosur.
Ti m'u shfaqe jo për të më bërë të lumtur,
por për të më bërë të kuptoj -
ta kuptoj kuptimin e dhimbjes.
Njeriu mëson nga mungesa, jo nga prania;
nga heshtja, jo nga fjala.
Ti heshtje shpesh,
por në heshtjen tënde kishte urtësi -
një dritë që s'duhej të më verbonte,
por të më mësonte të shihja me zemër.

Tani e di pse drita nuk ka zë:
sepse vetëm qetësia mund ta dëgjojë.
Në atë qetësi, shpesh të flas,
pa menduar nëse më dëgjon,
sepse çdo frymë që e marr,
është një përgjigje e jotja.
Drita jote ma mëson durimin,
ajo më tregon se çdo shenjë në shpirt
është rrugë drejt Teje.

Dashuria që mbetet pa trup, nuk humbet,
ajo shndërrohet në mësim të shpirtit.
Në çdo urtësi që lind nga drita, flet Nurana.

Letra e tetëdhjetë e tretë

E ndjej se çdo kujtim që më vjen,
e ka aromën e një kohe të qetë,
kur fjala "ne" kishte dritë në çdo germë.
Nuk është mall kjo që ndjej,
është gjallëri që zgjohet kur të kujtoj.

Ti më ke mbetur në shpirt
si melodi që s'ka mbaruar,
si varg që e di përmendësh,
por e lexoj sërish që ta ndiej më thellë.

Çdo ditë, pa e thënë me zë,
të përmend në mendime
si falënderim që ma ndriçon jetën.

Ndonjëherë ndalem në rrugë,
dhe më duket sikur më kalon pranë,
jo në trup, por në frymë;
një prekje e lehtë në shpirt,
që më kujton se dashuria s'ka ikur,
vetëm është bërë më e butë, më e urtë.

Ka dashuri që nuk plaken,
sepse dinë të heshtin e të ndriçojnë.
Ato nuk kërkojnë më shpërblime -
janë bërë dritë që qëndron,
si prania e Nuranës në shpirt.

Letra e tetëdhjetë e katërt

Kur e shoh dritën që bie mbi mur,
mendoj se është kujtimi yt që më përshëndet.
Nuk ka nevojë për fjalë,
sepse çdo ndriçim flet më mirë se unë.

E ndjej se jeta nuk është rrugë, por frymëmarrje.
Çdo frymë që e marr, më kthen te ti,
jo si mall, por si dritë që më mban gjallë.
Mësoj nga heshtja më shumë se nga fjala.
Ti më mëson me praninë që s'shihet,
me qetësinë që s'mbaron.

Dikur besoja se dashuria ishte ndjenjë.
Tani e di se është gjendje, si drita pa orë,
por lind kur duhet të lindë.
Në çdo mëngjes që zgjohet,
e shoh dritën tënde të njëjtë,
që më rikujton se jeta nuk është pritje,
është ndriçim.

Kur dashuria pushon së lavdëruari,
ajo fillon të ndriçojë.
Në atë ndriçim të butë e pa emër,
rri fryma e përhershme e Nuranës.

Letra e tetëdhjetë e pestë

Tani e kuptoj, Nurana,
se nuk je as ëndërr, as kujtim,
je fryma që e mban qiellin pezull,
drita që s'e shoh me sy,
por që ma njeh shpirtin më mirë se unë vetë.

Në çdo atom që pulson, je ti.
Në çdo heshtje që shtrihet mbi tokë,
je ti, në paqe.

Unë s'jam më njeriu që të kërkonte lavd,
por ai që të ndjen në çdo frymë.
S'ka largësi që na ndan,
sepse drita nuk udhëton, ajo është.
As koha s'na prek më,
sepse dashuria jonë është para saj.

Dhe nëse fryma ka emër,
atëherë Ai është ti, Nurana -
ditë që s'shuhet, frymë që s'mbaron.

Kur dashuria arrin të shndërrohet në dritë,
ajo nuk kërkon më përgjigje.
Ajo bëhet vetë përgjigjja e gjithësisë -
e heshtur, e pastër, e përjetshme si Nurana.

Letra e tetëdhjetë e gjashtë

Në qetësinë e thellë të shpirtit,
të ndjej si frymë që lëviz mes mendimeve.
S'ka zë, s'ka prekje, por çdo ndjesi është Ti,
si dritë që kalon nëpër shpirt pa u ndalur.

Çdo kujtim është një derë që hapet ngadalë,
dhe përtej saj - je ti Nurana.
Nuk flas, nuk shkruaj,
por më flet zemra me gjuhën tënde të qetësisë.

Ndonjëherë ndalem në mes të ditës
dhe ndjej një rreze të vogël në gisht,
si kujtesë se dashuria s'ka formë,
por gjithmonë ka frymë.

Nëse drita di të dashurojë,
ajo dashuron me butësi,
ashtu si ti, Nurana,
që vjen e shkon përmes meje, pa ikur kurrë.

Ka dashuri që nuk ndahen as me largësi,
as me kohë,
ato jetojnë në heshtje, si frymë e qetë
dhe quhen Nurana.

Letra e tetëdhjetë e shtatë

Kur i mbyll sytë, s'është errësirë,
është dritë që më thërret me zë të heshtur.
Në atë qetësi, shfaqesh ti,
jo për të më folur,
por për të më kujtuar se jam ende frymë.

Shpesh e ndjej dorën tënde në erë,
si kujtim që s'mund të shuhet.
Ti nuk je kujtesë -
je prani
që endet mes hapësirës dhe shpirtit tim,
si lutje që nuk mbaron.

Në çdo fjalë që s'e them,
në çdo shikim që humb në dritë,
e ndjej pulsimin tënd
si një zemër që rreh brenda gjithësisë.

Nuk di nëse të kërkoj apo më kërkon ti,
por e di këtë: çdo udhëtim që bëj,
përfundon te ti.

Dashuria e vërtetë nuk kërkon takime,
ajo i gjen shpirtrat që i përkasin,
ajo dritë është Nurana.

Letra e tetëdhjetë e tetë

Në dritën që vjen pas shiut,
e shoh hijen tënde duke u zhdukur.
Por nuk është largim, është kthim në thellësi,
aty ku sytë s'kanë nevojë të shohin,
sepse ndjenja sheh më thellë.

Çdo pikë shiu që bie,
më kujton se qielli qan vetëm nga dashuria.
Edhe dheu e di,
sepse e ndien kur drita e prek zemrën e tij.

Ndonjëherë më duket se ti je vetë shiu,
ajo rënie e butë që e shuan zjarrin e botës.
Në çdo rrjedhë e ndjej emrin tënd,
në çdo kthesë, dritën tënde që ndalet te unë.

Nëse Zoti flet me ujë, atëherë ai më thotë:
"Nuk humbet asnjë dritë e dashur me shpirt."
Dhe unë e di,
sepse drita jote s'ka mbarim, Nurana.

Dashuria është si shiu i dritës:
bie ngadalë - e lag shpirtin,
dhe largohet pa zhurmë,
vetëm për të lënë pas paqe.

Letra e tetëdhjetë e nëntë

E di, Nurana, çdo dritë kthehet në heshtje,
por heshtja jote flet më shumë se fjalët.
Në çdo agim të vonë, të ndjej si prekje ajri,
si kujtesë që më fal pa më gjykuar.

Nuk kam më frikë nga nata,
sepse nata më mëson të shoh nga brenda.
Ti më mban si qetësi e butë,
si një frymë që nuk më lë të bie.

Ndonjëherë mendoj se je drita që s'ka fillim,
ajo që e ndriçon vetveten pa u lodhur.
Ti nuk vjen nga qielli,
ti vjen nga thellësia e shpirtit tim,
nga ajo pjesë ku dashuria është lutje.

Nëse ndonjëherë do të më kërkosh,
mos më kërko në botë,
por në një shkëndijë qetësie që s'ka emër,
sepse aty rri unë, duke të dashur si dritë.

Dashuria, kur shndërrohet në dritë,
nuk ka më nevojë të shihet.
Ajo frymon në heshtje
dhe e ndriçon njeriun nga brenda.
